

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Nikollë Komani kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit T. B. nga fshati B., Komuna Malishevë, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I nr.117/2016 të datës 19.09.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **18.11.2016**, në prezencën e Prokurorit Agron Matjani, të akuzuarit T. B., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **T. B.** i biri i I. dhe A., e gjinisë B., i lindur më datë ... në fshatin B., Komuna Malishevë, ku edhe tani banon, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, student, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më parë ka siguruar e gjerë me datë 08.05.2016 pa autorizim ka poseduar armë, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla dhe atë një pistoletë të tipit E. S. 99, kalibër 9 mm P.A.K me numër serik EV-1173753, në atë mënyrë që ditën kritike stacioni policor në Malishevë, është njoftuar nga stacioni policor në Prishtinë, se janë ndaluar dy persona dhe njëri prej tyre ishte vëllai i të pandehurit T. D. B. dhe gjatë kontrollit të telefonit të tij është gjetur një foto, ku i pandehuri T.B. posedonte një armë, ashtu që menjëherë stacioni policor në Malishevë me të marrë këtë informatë, ka kontaktuar me të pandehurin ku kanë shkuar në shtëpinë e tij dhe kanë sekuestruar armën e lartë cekur.

- **me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 6, 17, 41, 49, 50, 51, 52 par. 1, 73, 374 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, i shqipton:

D Ë N I M M E K U S H T

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **40,00 €**, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Konfiskohet pistoleta e tipit E. S. 99, kalibër 9 mm P.A.K, me numër serik EV-1173753, si objekt i kryerjes së kësaj veprë penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP/I. nr. 117/2016 të datës 19.09.2016, ka akuzuar T. B. nga fshati B., Komuna Malishevë, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori Agron Matjani para leximit të aktakuzës ka theksuar se nga dispozitivi i aktakuzës duhet të hiqet fjala municion, ndërsa pas leximit të aktakuzës dhe deklarimit të akuzuarit që e pranon në tërësi fajësinë ka shtuar se propozon që pranimi i fajësisë të aprovohet, pasi pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pa presion, i akuzuari i ka kuptuar pasojat e pranimi të fajësisë dhe pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e bashkëngjitura aktakuzës. Ka shtuar se propozon që i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, mirëpo gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin i ka propozuar gjykatës që si rrethanë lehtësuese të ketë parasysh pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte gjatë gjykimit, është hera e parë që paraqitet pranë gjykatës, është student dhe i moshës së re, andaj propozon që ti shqiptohet një dënim sa më i butë, si dhe ka theksuar se bazuar në nenin 374 par. 3 të KPRK-së, të konfiskohet arma si objekt i kryerjes së kësaj veprë penale.

I akuzuari T. B. duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon fajësinë, ka shtuar se armën e ka dorëzuar në stacioni policor po sa e kanë pyetur policia, a ekziston kjo armë, ai u është përgjigjur po dhe të njëjtën e ka dorëzuar.

Pasi që Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e fajësisë e ka bërë në baza vullnetare dhe ka konstatuar se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat bashkëngjitura aktakuzës, si raporti i oficerit policor i datës 08.05.2016 dhe fotot e armës së konfiskuar, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së, e ka bërë pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit dhe shqyrtimin e ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale, në mënyrën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marr parasysh pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit, jo dënueshmërinë tij të mëparshme, është student, e të cilat rrethana kanë ndikuar që të akuzuarit T. B. ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e revoles të tipit E. S. 99, kalibër 9 mm P.A.K, me numër serik EV-1173753, është marrë bazuar në nenin 374 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.6 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
PKR. nr. 120/16 datë 18.11.2016

Sekretarja Juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
Nikollë Komani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj Gjykate.